



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.958/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, në çështjen përmbarimore të kreditorit ProCredit Banka, sh.a, Dega ne Prishtine Bulevardi “Bill Clinton” pn, ndaj debitorëve: 1. “Dashi” DPH/D.V. BI, me nr. Biznesi 71090167, me seli ne fshatin Lubizhdë Prizren, 2. Sh.V. me adresë banimi ne fshatin Lubizhdë Prizren, 3. D.V. me adrese banimi ne fshatin Lubizhdë Prizren, 4. R.V. me adresë banimi ne fshatin Lubizhdë Prizren, me baze juridike përmbarimore, duke vendosur sipas ankesës se debitorit R.V., kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1549/22 dt.19.03.2024, me datë 29.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit R.V. me adresë banimi ne fshatin Lubizhdë Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1549/22 dt.19.03.2024 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës - Dhomat e Shkalles se Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 1549/22 dt.19.03.2024, ka refuzuar si te pabazuar prapësimin e debitorit “Dashi” DPH/D.V. BI, me nr. Biznesi 71090167, me seli ne fshatin Lubizhdë Prizren, ndërsa Urdhrin për përmbarim P.nr.183/22 dt.31.03.2022, te lejuar nga Përmbaruesi Privat Rushit Hoxha Prizren e ka lenë ne fuqi.

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë debitori R.V., për shkak te shkeljeve esenciale te dispozitave te LPP, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe aplikimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkallës se dytë ta aprovoj ankesën e debitorit si te bazuar ndërsa aktvendimin e atakuar ta prish.

Përgjigje ne ankesën e debitorit ka ushtruar kreditori duke propozuar qe gjykata ta refuzoj si te pabazuar ankesën e debitorit dhe aktvendimin e atakuar ta vërtetoj.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit R.V. e është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ProCredit Banka, sh.a, Dega ne Prishtine Bulevardi “Bill Clinton” pn, me datën 31.03.2022, ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorëve: 1. “Dashi” DPH/D.V. BI, me nr. Biznesi 71090167, me seli ne fshatin Lubizhdë Prizren, 2. Sh.V. me adresë banimi ne fshatin Lubizhdë Prizren, 3. D.V. me adrese banimi ne fshatin Lubizhdë Prizren, 4. R.V. me adresë banimi ne fshatin Lubizhdë Prizren, në bazë të dokumentit përbarues: Kontratë mbi Themelimin e Hipotekës LRP.nr.1625/2018. Ref.nr.237/2018 dt. 13.04.2018, Aktvendim mbi regjistrimin e Hipotekës nr.prot.07-463-04/52970/H dt.16.04.2018, lëshuar nga Zyra Komunale e Kadastrit ne Prizren, Kontrata Kornize e Kredisë për Biznes nr.FË89.1245, Kontrata e Pengut Shtojca nr.1 e Kontratës Kornizë e Kredisë për Biznes, Konfirmim i regjistrimit te Pengut R-20180403-13 lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Zyra për Regjistrim te Pengut, për shumën e detyrimit në vlerë totale prej 132,554.81 euro, me kamatë te rregullt si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Ndaj urdhrit për përbarim debitori DPH Dashi, ka parashtruar prapësim me datën 08.04.2022, me pretendimin se për shkak te pandemisë se Covidit kemi pasur problem dhe për këtë e kanë njoftuar bankën ku kane kërkuar shtyrjen e pagesave për një kohë e cila nuk ka pranuar qe te me shtyj ose zvogëloj pagesat, shton se banka ka marrë afro 5,000.00 euro deri me tash, propozon qe gjykata ta pranoj prapësimin e debitorit dhe vendimi i përbaruesit te prishë.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka ushtruar kreditori, me datën 08.04.2022, me pretendimin se prapësimi i debitorit është i pabazuar, nuk përmban asnjë nga shkaqet e parapara me nenin 71 te LPP, propozon qe gjykata ta refuzoj si te pabazuar prapësimin e debitorit ndërsa urdhrin përbarimor ta lë ne fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkalles se Parë, pas vlerësimit te prapësimit dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerr aktvendim KPPP.nr.1549/22 dt.19.03.2024, me te cilin ka vendos si ne dispozitiv te aktvendimit. Ka arsyetuar se prapësimi i debitorëve është ne tërësi i pabazuar, dokumentet ne baze te cilit është lejuar përbarimi i plotësojnë kushtet ligjore për te qenë dokumente përbaruese konform nenit 22, 27 te LPP dhe nenit 5 par.2 te ligjit 05./L-118 për Ndryshimin e ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën përbarimorë. Gjykata i referohet nenit 21 te LPP, 22 pika 1, 1.7dhe nenit 27 te LPP duke arsyetuar se dokumentet mbi bazën e te cilave është lejuar përbarimi janë paraqitur ne origjinal, janë hartuar ne formën e paraparë me ligj, janë regjistruar ne regjistrat publik, gjë qe vërtetohet me konfirmim te regjistrimit te pengut si dhe

aktvendimit për regjistrimin Hipotekës dhe si te tilla përbejnë bazë juridike për caktimin e përmbartimit sepse i kanë plotësuar kushtet ligjore nga neni 22 pika 1.7 dhe 1.7 a) lidhur me nenin 27 të LPP dhe janë të përshtatshme për përmbartim, gjykata ka vlerësuar se nuk ekziston asnjë nga bazat ligjore nga neni 71 i LPP dhe në kuptim të nenit 73 e LPP vendosi si në dispozitivin e aktvendimit.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu drejtë është vërtetuar edhe gjendja faktike nga neni 183 të LPK.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes drejtë ka vlerësuar ligjshmërinë e përmbartimit pasi që në rastin konkret dokumentet në bazë të cilave është caktuar përmbartimi i plotësojnë kushtet e parapara me dispozita ligjore për të qenë dokumente të përmbartueshme, pasi kontrata mbi hipotekën është kopje noteriale e vërtetuar, siç parashihet me dispozitat ligjore. Dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përmbartimi në përjashtim të Kontratës mbi Themelimin e Hipotekës LRP.nr.1625/2018. Ref.nr.237/2018 dt. 13.04.2018 nga e cila vërtetohet ekzistenca e kërkesës materialo juridike e kreditorit është prezantuar e noterizuar. Neni 21 i LPP përcakton se *“Organi përmbartues e cakton përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa neni 36 par.1 të LPP përcakton se *“Se bashku me propozimin për përmbartim, organi përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”*, andaj, mbi bazën e këtyre arsyeve gjykata e shkallës së dytë vlerëson se aktvendimi i antakuar është i rregullt.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhoma e Shkalles së Dytë  
K.DH.SH.II nr. 958/24, me datë 29.11.2024

Gjyqtari  
Dren Rogova